



Tregu Veror

QËLLIMI

Tregu Veror është aktivitet i ideuar dhe organizuar nga Komuna e Prishtinës (Kryeqyteti) për të gjithë qytetarët që të argëtohen në hapësira publike me muzikë, ushqim, pije dhe aktivitete të shumta.

Tregu Veror po ashtu ju ofron mundësi bizneseve të qytetit që të ofrojnë shërbimet e tyre në hapësira publike, përgjatë rrugës Xhorxh Bush, nga kryqëzimi me Rr. Bill Klinton e deri tek kryqëzimi me Rr. Garibaldi. Tregu do të përbëhet nga 1 skenë për performance dhe 40 shtëpiza të drurit.

RREGULLAT E TREGUT VEROR

1) Vendi dhe orari i punës

Hapja e tregut veror do të bëhet më 4 Gusht 2023 në ora 20:00 dhe do të jetë i hapur deri më 31 Gusht 2023 në ora 24:00. Gjatë kësaj kohe bizneset e përzgjedhura për shtëpiza lejohen të punojnë çdo ditë, nga e hëna në të dielën duke filluar prej orës 10:00 deri në orën 24:00.



2) Kriteret e aplikimit

Përzgjedhja e bizneseve të cilat do të jenë pjesëmarrëse në tregun veror do të bëhet nga komisioni i formuar me Vendim të Kryetarit të Kryeqytetit.

Aplikimi i kriterëve si më poshtë do të jetë përcaktues në mënyrë që përzgjedhja e bizneseve të jetë sa më adekuate:

- Bizneset do të aplikojnë për produkte ushqimore, laramani të pijeve freskuese si dhe ide të ndryshme të realizueshme me motive verore;
- Bizneset aplikuese duhet të jenë të regjistruara në Administratën Tatimore të Kosovës, me adresë operimi në Komunën e Prishtinës;
- Bizneset aplikuese duhet të jenë të pajisur me mjete/vegla të përshtatshme pune për veprimtarinë të cilën do ta ushtrojnë në këtë aktivitet;
- Bizneset aplikuese duhet të paraqesin ofertën me çmimore për artikuj.
- Bizneseve të përzgjedhura do t'u lejohen vetëm 3 shankerica para shtëpizave tyre;
- Bizneset e përzgjedhura obligohen të kenë sigurim fizik për shtëpizat e tyre;
- Bizneset e përzgjedhura obligohen të kenë që afër shtëpizës t'a kenë shportën për mbeturinat personale.

3) Përparësi në përzgjedhje do të kenë:

- Bizneset të cilat dorëzojnë formën e aplikimit të parat që nga data e njoftimit.
- Bizneset të cilat promovojnë përdorimin e produkteve lokale/vendore;
- Bizneset që ofrojnë produkte ushqimore inovative në fushën e kulinarisë dhe produkte që kanë të bëjnë me motive të stinës së verës;

4) Tarifa e shfrytëzimit të shtëpizës

Tarifa për shfrytëzimin e shtëpizave të tregut veror, për periudhën sa është i hapur tregu, është 500 Euro.



5) Obligimet

Secili biznes që merr lejen e ofrimit të shërbimeve/produkteve në tregun veror ka këto obligime:

- Të bëjë pagesën e tarifës me nënshkrimin e kontratës;
- Të bëjë vetëm shitjen/shërbimin e produkteve me të cilat ka aplikuar/është përzgjedhur;
- Të respektojë orarin e përcaktuar të punës;
- Të vendosë në vend të dukshëm çmimoren e shërbimeve/produkteve;
- Të sigurojë hapësirën dhe mjetet e punës kundër dëmtimit/vjedhjes;
- Të mban hapësirën përreth gjithmonë pastër;
- Të mos shfrytëzojë hapësirën për kryerjen e veprave të jashtëligjshme;
- Të mos e jep në shfrytëzim hapësirën palëve të treta;
- Të kthejë shtëpizën/hapësirën në gjendjen e mëparshme me mbylljen e tregut dhe merr përgjegjesinë për demet eventuale.
- Ndalohet ndotja akustike brenda/jashtë shtëpizave.

6) Mënyra e Aplikimit

- Një person juridik ka të drejtë aplikimi vetëm për një shtëpizë;
- Aplikuesit në aplikacion duhet t'i bashkëngjeshin dokumentet përcjellëse: kopjet e çertifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kartelën identifikuese. Afati për aplikim: 19.07.2023-28.07.2023 Komuna e Prishtinës (ndërtesa e vjetër), sporteli nr.1;

Njoftimi i bizneseve të përzgjedhura do të bëhet përmes platformave infomuese të komunës.



6) VËREJTJE

Komuna e Prishtinës (Kryeqyteti) nuk merr përsipër përgjegjësinë dhe obligimet ndaj Administratës Tatimore të Kosovës rreth arkës fiskale.

Nëse nuk zbatohet kodi i mirësjelljes i sqaruar më lartë, bizneset do të sanksionohen me largimin e tyre, do të futen në listën e zezë të Kryeqytetit si dhe nuk do të bëhet kthimi i mjeteve të paguara për shfrytëzimin e saj.